



Tel: +355 4 22 69097  
+355 4 22 69325  
Fax:  
E-Mail: info@dpa.gov.al

## Kontratë me vlerësues/kryevlerësues/ekspertë

Kodi DA-FO-037

Rishikim nr 3  
Dt: 03.04.2023

Faqe 1 nga 4

### Kontratë me vlerësues/ kryevlerësues/ekspertë

Kjo kontratë, nënshkruhet sot me datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ në Tiranë, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) të quajtur “pala kontraktuese” dhe

\_\_\_\_\_ të quajtur në vazhdim “vlerësues”.

Palët në këtë kontratë ranë dakort si më poshtë:

#### 1. Subjekti i kontratës:

Pala kontraktuese kërkon nga vlerësuesi të kryejë si \_\_\_\_\_ (kryevlerësues, vlerësues, ekspert) në fushën e \_\_\_\_\_ në emër të DPA-së shërbimet e nevojshme në lidhje me akreditimin/mbikqyrjen/riakreditimin/vlerësimet shtesë të organeve të vlerësimit të konformitetit (OVK) në një procedurë të marrjes/mbajtjes/zgjerimit të akreditimit.

Vlerësuesi pranon të kryejë këto shërbime në përputhje me legjislacionin shqiptar, standardet europiane dhe ndërkombëtare, udhëzuesit e organizmave europiane dhe ndërkombëtare të akreditimit si dhe procedurat e miratuara nga pala kontraktuese.

#### 2. Të drejtat dhe detyrimet e palëve

##### A. Pala kontraktuese duhet të:

A.1 Informojë vlerësuesin për punën e caktuar të paktën 1 muaj më parë në rastet e vlerësimit dhe mbikqyrjes dhe të paktën 10 ditë para në rastet e vizitave shtesë.

A.2 Ndihmojë në sigurimin e kushteve të nevojshme për punën normale të vlerësuesit gjatë vlerësimit të OVK, të cilat përfshijnë sigurimin e mundësisë për të shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe hyrjen në të gjitha ambientet, rregjistrimet, raportet, personelin, etj.

A.3 Hartojë në favor të vlerësuesit një faturë financiare mbi bazën e tarifave të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737 datë 09.09.2015 “Për përcaktimin e tarifave të akreditimit dhe për trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit”, i ndryshuar. Në rast se vlerësuesit i duhet të udhëtojnë në qytete të tjera jashtë rezidencës së tij atëherë në faturën financiare përfshihen edhe shpenzimet e udhëtimit, fjetjes dhe dietës ditore. Pagesa llogaritet mbi bazën “tarife për dite/vlerësimi”. Nga DPA njihet vetëm transporti publik ose transporti me



**Tel: +355 4 22 69097**  
**+355 4 22 69325**  
**Fax:**  
**E-Mail: info@dpa.gov.al**

## Kontratë me vlerësues/kryevlerësues/ekspertë

**Kodi DA-FO-037**

**Rishikim nr 3**  
**Dt: 03.04.2023**

**Faqe 2 nga 4**

automjete personale sipas normave të përcaktuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, sipas ligjeve në fuqi. Udhëtimi me taksi njihet vetëm për transport urban.

A.4 Informojë vlerësuesin kur pala kontraktuese organizon kurse trajnimi, seminare ose konferenca në fushën e akreditimit.

A.5 Trajnojë vlerësuesin sipas nevojave të përcaktuara nga pala kontraktuese. Kur puna e vlerësuesit konsiderohet jokorrekte nga pala kontraktuese, pala kontraktuese ka të drejtë të procedojë sipas procedurës DA-PM-002. Vlerësuesi ekspert teknik/kryevlerësuesi njoftohet nga sektori i personelit dhe burimeve financiare të DPA për rezultatet në trajnim.

A.6. Monitorojë punën e vlerësuesit tij/saj në periudha periodike, të paktën 1 herë në 3 vjet. Monitorimi bëhet në vizita vlerësuese ose me shqyrtim dokumentacioni. Monitorimi bëhet nga kryevlerësuesi, përfaqësuesi i DPA dhe nga OVK. Përfaqësuesi i DPA mund të jetë personel i përhershëm ose i përkohshëm i saj.

A.7 Informojë vlerësuesin për cdo ndryshim të bërë në procedurën e akreditimit, për çdo përditësim/ndryshim të standardeve apo udhëzuesve përkatës.


### **B. Vlerësuesit duhet të:**

B.1 Njohë dhe të kryejë punën e caktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet, udhëzuesit, procedurat dhe kërkesat e akreditimit të lëshuara nga DPA. Në veçanti duhet të njohë procedurat që kanë të bëjnë direkt me vlerësuesit DA-PM-002, DA-IN-003, DA-PT-002.

B2 Jetë i lirë nga cdo lloj presioni tregtar, financiar, familjar apo cdo lloj tjetër duke siguruar paanëshmërinë dhe mënjnuar konfliktin e interesave, të cilat mund ta shtyjnë të veprojë në mënyrë të njeanshme ose diskriminuese dhe të informojë DPA në rastet kur mund të ketë situata të tilla ose të krijohet përshtypja që mund të jenë të tilla..

B3 Mos ketë ofruar konsulenca gjatë 3 viteve te fundit, për organin që do të vlerësojë gjë që mund të kompromentoje paanëshmërinë e tyre në procesin e akreditimit.

B.4 Raportojë tek pala kontraktuese për punën e kontraktuar dhe të dorëzojë tek pala kontraktuese raportet, check-listat, format e moskonformitetit për OVK e vlerësuar/mbikqyrur, si dhe dokumentacionin e marrë nga pala kontraktuese dhe

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<b>Kontratë me  vlerësues/kryevlerësues/ekspertë</b>	<b>Kodi DA-FO-037</b> <b>Rishikim nr 3</b> <b>Dt: 03.04.2023</b> <b>Faqe 3 nga 4</b>
--	--	---

OVK, brenda shtatë ditësh nga data e vlerësimit. Në rast mosdorëzimi brenda afatit prej shtatë ditësh të raportit, check-listave, formave të moskonformiteteve për OVK-në e vlerësuar/mbikqyrur, si dhe të dokumentacionit të marrë nga pala kontraktuese dhe OVK, pagesa për vlerësuesit/ekspertët teknik/kryevlerësuesit do të reduktohet 3 % për cdo ditë vonese.

B.5 Marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga pala kontraktuese.

Vlerësuesit/ekspertët teknik/kryevlerësuesit e përfshirë në listë duhet të marrin pjesë në kurset kualifikuese, të organizuara nga DPA, sipas planit vjetor të trainimeve (DA-FO- 046). Ata aplikojnë për marrjen pjesë në trajnim duke plotësuar formularin ( DA-FO-050).

Verifikimi i njohurive kryhet mbi bazën e nje pyetësori të përgatitur nga ekspertët që organizojnë trainimin. Në rast se do të evidentohen mangësi mbi njohjen e kërkesave, standardeve, dhe procedurave të akreditimit dhe ato teknike, vlerësuesi/eksperti teknik/kryevlerësuesi transferohet në listën e vëshguesve dhe do të rivendoset në listën e vlerësuesve kur të kalojë një kontroll të mëtejshëm të DPA.

Nje vlerësues/ ekspert teknik/kryevlerësues brenda një viti do marrë pjesë të paktën në një prej kurseve trajnuese të organizuara nga DPA.

B6 Nënshtrohet monitorimit të organizuar nga DPA, të pranojë sistemin e vlerësimit të saj, të diskutojë rezultatin e monitorimit ose vlerësimit nëse e shikon të arsyeshme.

B7 Kërkojë të përfshihet në proces vlerësimi akreditimi, kur gjykon që ka patur paanshmëri nga ana e DPA-së ose shikon që rrezikohen limitet e kohës.

B8. Përfshihet në aktivitetet e tij teknike, të marë pjesë në trajnime, konferenca, simpoziume të fushës së tij të kompetencës teknike dhe të informojë në mënyrë të rregullt për këtë.

B.9 Firmosë “Deklaratën e Konfidencialitetit” përpara se të kryejë cdo vlerësim specifik ose mbikëqyrje/rivlerësim/vlerësim shtesë..

B.10 Përditësojë cdo fillim viti kalendarik dosjen e tij, dhe të informojë palën kontraktuese për çdo ndryshim në detajet e kontaktit si dhe t’i përgjigjet palës kontraktuese për plotësimin e dosjes së tij/saj kur kërkohet nga DPA.

**3. Zgjidhja e kontratës bëhet kur:**



**Tel: +355 4 22 69097**  
**+355 4 22 69325**  
**Fax:**  
**E-Mail: info@dpa.gov.al**

## Kontratë me vlerësues/kryevlerësues/ekspertë

**Kodi DA-FO-037**

**Rishikim nr 3**  
**Dt: 03.04.2023**

**Faqe 4 nga 4**

- 3.1 Paraqet paaftësi profesionale për kryerjen e punës dhe shkel detyrimet e përcaktuara në pikën B të kontratës;
- 3.2 I provohet fajësia për ndonjë vepër penale në ngarkim të tij dhe dënohet me vendim të formës së prerë të Gjykatës;
- 3.3 Kur kryen punë apo veprimtari që paraqesin konflikt interesash me detyrën e tyre;
- 3.4 Me kërkesën e punëmarrësit, duke respektuar afatin e njoftimit të përcaktuara në Kodin e Punës.

### 4. Kushte të tjera

- 4.1 Pala kontraktuese rregjistron vlerësuesin në rregjistrin e vlerësuesve e cila shpallet në internet.
- 4.2 Kontrata hyn në fuqi në datën e firmosjes së saj nga të dyja palët.
- 4.3 Vlerësuesi angazhohet se do të respektojë të gjitha rregullat dhe detyrimet që përcaktohen në këtë kontratë.
- 4.4 Palët në këtë kontratë duhet të përpiqen maksimalisht për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ngritura nga të dy palët. Në rast të kundërt zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi për interpretimin e kësaj kontrate dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 4.5 Kontrata hartohet në 2 kopje origjinale të njëjta dhe palët do të pajisen me 1 kopje secili.
- 4.6 Kjo kontratë bëhet e vlefshme bashkëngjitur me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm për miratimin e vlerësuesit pas së cilës bëhet rregjistrimi.

**Pala kontraktuese**  
Drejtori i Përgjithshëm  
Pranvera Fagu  
Firma

Data

**Vlerësuesi**

Firma

Data